

Tiranë, më 17.03.2026

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Mirëmbajtje e sistemeve të peshimit”, për nevoja të e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP):** 42958000-6, 51210000-7.

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 7 240 000 (shtatë milion e dyqind e dyzet mijë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formulari i ofertes sipas Shtojcës 1;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohet në nenin 82 dhe 83 të LLP-së Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe nenet 14/1, 14/2, 25, 26 të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

Argumentimi:Ky kriter u vendos sipas nenit 29 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e parashikuar se: 1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH. 2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.

## b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cileneshte e parashikuar se: Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

## c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10;

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne te cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”.

### 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

#### 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Autorizim nga Drejtoria e Përgjithshme e Peshëmatjes, përcaktuar në Urdhërin Nr. 194, datë 09.03.2009 të “Për miratimi e rregullorës për autorizimin e personave juridike për kryerjen e veprimtarive në metrologjinë ligjore dhe për autorizimin e personave juridike dhe fizike për kryerjen e shërbimit të riparimit të instrumentave matëse”, të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, të Ligjit Nr. 126/2020 “Për Metrologjinë”, të Urdhërit Nr. 194, datë 09.03.2009 të “Për miratimi e rregullorës për autorizimin e personave juridike për kryerjen e veprimtarive në metrologjinë ligjore dhe për autorizimin e personave juridike dhe fizike për kryerjen e shërbimit të riparimit të instrumentave matëse”, si dhe Vendimit Nr. 631, datë 25.9.2019 “Për miratimin e rregullit teknik “Për instrumentet e peshimit joautomatik” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara.

Kërkesa që operatori ekonomik të jetë i pajisur me autorizim nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë është vendosur për të garantuar që subjektet pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit publik të kenë kapacitetin e nevojshëm teknik dhe ligjor për kryerjen e veprimtarive që lidhen me instrumentet matëse dhe peshimit. Në përputhje me legjislacionin për metrologjinë, instrumentet e matjes që përdoren në veprimtari ekonomike dhe tregtare duhet të jenë të kontrolluara dhe të mirëmbajtura nga subjekte të autorizuar, me qëllim garantimin e saktësisë së matjeve, mbrojtjen e interesave të konsumatorëve dhe funksionimin korrekt të tregut. Gjithashtu, kjo kërkesë lidhet me zbatimin e rregullit teknik të miratuar me Vendimin nr. 631, datë 25.09.2019 “Për instrumentet e peshimit joautomatik”, i cili përcakton standardet dhe kërkesat teknike për këto instrumente.

Për rrjedhojë, ky kriter është i domosdoshëm për të garantuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë janë subjekte të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi dhe kanë aftësinë teknike dhe profesionale për realizimin korrekt të shërbimeve që lidhen me instrumentet e peshimit dhe matjes, duke siguruar njëkohësisht respektimin e standardeve ligjore dhe teknike në këtë fushë.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është vendosur në përputhje me nenin 77, pika 1/b dhe pika 3, e LPP-së Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, pasi është në të drejtën e Autoritetit Kontraktor të vendosi kërkesa të cilat garantojnë se operatorët ekonomik pjesëmarrës kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën si dhe në nenin 43 të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Autoriteti Kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon një kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.”* Gjithashtu në përputhje me nenin 55, pika 4, paragrafi 1 dhe 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.”*

Në vendosjen e këtij kriteri është mbajtur në vëmendje neni nr. 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si edhe rekomandimi APP-së nr. 7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin me sukses të kontratës dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4, gërma b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara. Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 55, pika 4, gërma b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt prokurimi, duhet të disponojë minimumi 2 (dy) punonjës, të cilët duhet të jenë të pajisur me certifikatë nga një trupë certifikues, për vlerësimin konform instrumentave sipas modulit D, kreu III “Konformiteti i Instrumentave” bazuar në Vendimin Nr.631, datë 25.9.2019 “Për miratimin e rregullit teknik “Për Instrumentet e Peshimit Joautomatik” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara” si dhe Ligji Nr. 126/2020 datë 15.10.2020 “Për Metrologjinë”.

Punonjësit e mësipërm duhet të pasqyrohen dhe në listë-pagesat të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit të deklaruar, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Për punonjësit e kërkuar në këtë kriter, duhet të paraqiten dokumentat:

- kontratën individuale të punës të vlefshme;
- Certifikatë mbi aftësitë teknike për vlerësimin e konformitetit të instrumentave të peshimit, lëshuar nga një organ i akredituar.

*Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DST, **duke deklaruar dhe personat të cilën do të angazhohen për kryerjen e këtij shërbimi.** Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë minimumi 2 (dy) punonjës të pajisur me certifikatë për vlerësimin e konformitetit të instrumenteve të peshimit sipas modulit D është vendosur për të garantuar që shërbimet që do të realizohen nga personel i kualifikuar dhe i certifikuar, në përputhje me kërkesat teknike dhe ligjore në fuqi. Duke qenë se objekti i kontratës lidhet me instrumente të peshimit, është e domosdoshme që verifikimi dhe vlerësimi i konformitetit të këtyre instrumenteve të kryhet nga specialistë të trajnuar dhe të certifikuar nga organe ose trupa certifikuese të akredituara, të cilat garantojnë kompetencën profesionale dhe teknike të personelit. Kërkesa për një numër minimal prej 2 (dy) specialistësh është përcaktuar për të siguruar që operatori ekonomik të ketë kapacitetet e nevojshme njerëzore për realizimin e shërbimeve në mënyrë të vazhdueshme si dhe për të garantuar realizimin e kontratës brenda afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Gjithashtu, kjo kërkesë siguron që operatori ekonomik të ketë personel të mjaftueshëm për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale edhe në rast të mungesave të përkohshme të njërit prej specialistëve. Paraqitja e dokumentacionit që vërteton marrëdhënien e punës së këtyre punonjësve me operatorin ekonomik, si kontrata individuale e punës dhe listë-pagesat e deklaruara pranë autoriteteve përkatëse, kërkohet me qëllim që të provohet disponueshmëria reale e këtij personeli për realizimin e shërbimit objekt prokurimi.

2.3.3 Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt prokurimi, duhet të disponojë të paktën 2 (dy) automjete të kompletuara me pajisje për shërbimin e mirëmbajtjes dhe të pajisur me dokumentacionin e kërkuar nga ligji. Mjetet mund të jenë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: dokumentacion të plotë si akti që vërteton pronësinë, kontratë qiraje/përdorimi/shërbimi, (e vlefshme), dhe leje qarkullimi (e vlefshme), policë sigurimi (e vlefshme), certifikatë kontrolli teknik (e vlefshme), taksa vjetore.

*Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor. Autoriteti Kontraktor pas dorëzimit të dokumentacionit të mësipërme, përpara publikimit të Njoftimit Fitues përfundimtar do të verifikojë pranë ambienteve të operatorëve disponueshmërinë e automjeteve.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet e nevojshme për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Duke qenë se shërbimet që do të realizohen lidhen me mirëmbajtjen dhe ndërhyrjen në instrumente matëse/peshimi, është e domosdoshme që operatori ekonomik të ketë në dispozicion mjete transporti të përshtatshme për transportin e pajisjeve, instrumenteve dhe materialeve të nevojshme, si dhe për kryerjen e ndërhyrjeve teknike në terren.

Disponimi i automjeteve të pajisura për këtë qëllim siguron që operatori ekonomik të jetë në gjendje të reagojë në kohë dhe të realizojë shërbimin në mënyrë efikase, duke garantuar mobilitetin e stafit teknik dhe transportin e sigurt të pajisjeve të nevojshme për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes. Gjithashtu, përcaktimi i një numri minimal prej 2 (dy) automjeteve është bërë për të garantuar vazhdimësinë e shërbimit dhe për të shmangur vonesat në realizimin e kontratës në rast të pamundësisë së përdorimit të njërit prej mjeteve si/ose shfaqjen e problematikave teknike njëkohësisht në dy pika doganore të ndryshme.

Për rrjedhojë, ky kriter konsiderohet i domosdoshëm dhe proporcional me natyrën e shërbimit që kërkohet të realizohet, pasi garanton që operatori ekonomik disponon kapacitetet e nevojshme logjistike për të realizuar në mënyrë të rregullt, të sigurt dhe brenda afateve shërbimin objekt prokurimi.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër të kryejë shërbimin sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i cili lejon Autoritetin/entit kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, me qëllim që AK të krijojë siguri për që ofertuesi merr përsipër ekzekutimin e kontratës/ave, sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përlllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Njësia e prokurimit: